

VENDIM
Nr.708, datë 24.10.2012

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE DHE PËR
MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME**

(Ndryshuar me VKM nr. 877, datë 12.12.2012)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e vitit 2012, në zërin “Projekte”, artikulli 604, t’i shtohen, përkatësisht, fondet:

a) 17 637 600 (shtatëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) lekë, për mbulimin e shpenzimeve të realizimit të projektit “Dekori i 100-Vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë”;

b) 27 978 624 (njëzet e shtatë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e njëzet e katër) lekë, për mbulimin e shpenzimeve për dekor, transmetimin e spoteve dhe mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për koncertin në Bruksel, në kuadër të 100-Vjetorit të Pavarësisë.

1/1. Ministrisë së Punëve të Jashtme, në Buxhetin e Vitit 2012, në artikullin 602, t’i shtohet fondi në shumën 2 840 000 (dy milionë e tetëqind e dyzet mijë) lekë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për koncertin në Bruksel, me rastin e 100-Vjetorit të Pavarësisë.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha